



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 1330 / Prot.
2

Tiranë, më 19.7. 2021

URDHËR

Nr. 231, Datë 19.7.2021

PËR

DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 210, DATË 03.07.2020, "PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË "BACHELOR" NË "ADMINISTRIM BIZNESI" ME PROFILE "MARKETING", "EKONOMI BIZNESI" DHE "MENAXHIM", NË UNIVERSITETIN E NEW YORK-UT, TIRANË"

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 73 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Titulli dhe pika 1 e urdhrin nr. 210, datë 03.07.2020, të ndryshojë si më poshtë:

"Për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Administrim Biznesi" me profile "Administrim Biznesi", "Marketing", "Ekonomi Biznesi" dhe "Menaxhim", në Universitetin e New York-ut, Tiranë".

1. Riorganizimin e programit të studimit të ciklit të parë nga "Bachelor" në "Administrim biznesi" me profil në "Administrim biznesi", me kohëzgjatje normale 4 vite akademike (8 semestra), në programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Administrim biznesi" me profile "Administrim Biznesi", "Marketing", "Ekonomi Biznesi" dhe "Menaxhim" në Universitetin e New York-ut, Tiranë, me 180 kredite dhe kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë.

Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Bachelor” në “Administrim biznesi” me profile “Administrim Biznesi”, “Marketing”, “Ekonomi Biznesi” dhe “Menaxhim”, në Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit, në Universitetin e New York-ut, Tiranë, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.”.

2. Pika 2 e urdhrit nr. 210, datë 03.07.2020 të ndryshojë si më poshtë:

“Veprimtaria akademike në programin e riorganizuar të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Administrim biznesi” me profile “Administrim Biznesi”, “Marketing”, “Ekonomi Biznesi” dhe “Menaxhim”, në Universitetin e New York-ut, Tiranë, fillon në vitin akademik 2020-2021.”.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti i New York-ut, Tiranë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Evis KUSHI

